



## REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KF.nr.10/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli dhe me këshilltaren profesionale Diana Dodaj Sopjani, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit Sigkos me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.R kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimore, vlerë kontesti 183,811.85 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të paditësit H.R, dhe në mungesë të palës së paditur, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Sigkos me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.R si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.329/2019 i datës 16.09.2019, i Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

Paditësi me padinë e parashtruar në gjykatë me datë 18.10.2019, ka kërkuar aprovimin e padisë si të bazuar, ndryshimin e pjesshëm të vendimit kontestues nr. 329/2019 të datës 16.09.2019, ashtu që e paditura obligohet t'ia rimburojë-kthejë shumën prej 201,267.74 euro të inkasuar në emër të ndëshkimeve dhe të interesit për premitë e policave të

detyrueshme për periudhën 01/2011-12/2011, me kamatë ligjore 8% nga data e kryerjes së pagesave e deri në datat e pagesave definitive. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalës përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse ka deklaruar se: ne e pranojmë në tërësi ekspertizën nga eksperti financiar, nuk kemi vërejtje dhe nuk kemi ndonjë pyetje për ekspertin, gjithashtu pajtohemi me korigjimin që e ka bërë eksperti lidhur me shumën totale të ndëshkimeve dhe interesit, ku ne kemi konstatuar shumën prej 201,262.74€, ndërsa eksperti ka konstatuar 183,811.85€, sepse ne gjatë kalkulimit mund të kemi bërë gabime. Edhe nga pretendimet të cilat i kemi paraqitur në padi por edhe nga ekspertiza financiare është vërtetuar se ndëshkimet dhe interesi për periudhën 02.12.2011-31.12.2011, ATK i ka vendosur në kundërshtim me ligjin. Andaj, kërkojmë nga gjykata që pas shqyrtimit dhe vlerësimit të fakteve dhe të ekspertizës ta aprovoj padinë si të bazuar, ta anuloj pjesërisht vendimin 329/2019 dhe ta detyroj ATK-në që shumën prej 183,811.85€, t'ia kthej Kompanisë së Sigurimeve Sigkos, duke përllogaritur edhe kamatën ligjore sipas Ligjit për Marrëdhënien e Detyrimeve. shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 15.01.2021 ka theksuar se Administrata Tatimore e Kosovës si palë e paditur në këtë konflikt administrativ, bazuar në faktet dhe dispozitat ligjore, vërtetimin e gjendjes faktike si dhe interpretimin e drejtë të dëshmive, kërkon nga gjykata që të vërtetoj vendimin e ATK-së nr. 329/2019 si të bazuar dhe të refuzoj si të pa bazë padinë e paditësit. Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar administrativ komfor dispozitave të nenit 41, të LKA-së për arsye se e paditura edhe pse ftesën për seancë e ka pranuar e njëjta përmes parashtrësë së datës 26.05.2023 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë dhe ka kërkuar nga gjykata që të veprojnë në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 të LKA-së. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 29.05.2023, ka administruar provat dhe atë: vendimi nr.329/2019 i datës 16.09.2019, rivlerësimet për TVSH-në, për periudhën 02/2011, 04/2011, 05/2011, 06/2011, 07/2011, 08/2011, 09/2011, 10/2011, 11/2011 dhe 12/2011, njoftimi për rivlerësim për periudhën 03/2011, përkujtesat për pagesat e vonuara, së bashku me pagesat bankare, qarkullimi për llogari bankare në “...” për periudhën

26.12.2012-27.12.2012, shkresa e BQK-së e datës 01.10.2010, shkresa e drejtuar BQK-së e datës 22.02.2012, shkresa e drejtuar ATK-së, e datës 05.03.2012, 15.03.2012, shkresa e drejtuar BKS-së e datës 12.03.2012, përgjigja në padi e datës 15.01.2021, raporti i kontrollit i datës 12.10.2012, ankesa e ushtruar në ATK e datës 08.11.2012, vendimi shpjegues publik nr. 02/2012, tabela gjendja e borxheve e datës së printimit 01.11.2021, ekspertiza financiare e datës 17.11.2022, parashtrësia e të paditurës-vlerësim për ekspertizë financiare.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjet në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, nga deklaratimet në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor Kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura vendimin kontestues e ka nxjerr në ri procedurë duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhënë përmes Aktgjykimit ARJ-UZVP nr. 58/2018 të datës 10.06.2019. nuk është kontestues as fakti se e paditura me vendimin kontestues ka aprovuar pjesërisht kërkesën e këtu paditësit duke e liruar nga tatimi në TVSH-ë për periudhën prej 02.11.2011 deri 31.12.2011 për premitë e policave vullnetare të sigurimit, dhe duke e lenë të pa ndryshuar vlerësimin tatimor sipas raportit të kontrollit për TVSH-ë për periudhën prej 01.07.2010 deri 31.12.2012 për premitë e policave të sigurimit të detyrueshëm. Nuk është kontestue as fakti se këtu paditësi me padinë e tij nuk ka kundërshtuar kalimin e TVSH-së së vjelur për periudhën kontestuese për policat e sigurimit të detyrueshëm tek e paditura, por se ka kundërshtuar ndëshkimet dhe interesat e aplikuara për këtë TVSH-ë, për shkak të mos deklaratimit me kohë të këtij lloji të tatimit pranë ATK-së.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.10/22 të datës 20.10.2022 ka caktuar ekspertizë financiare, përmes të cilës e ka obliguar ekspertin financiar që të konstatoj dhe vlerësoj detyrat si në këtë aktvendim.

Eksperti financiar Mentor Prekazi, në ekspertizën e datës 17.11.2022 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka dhënë mendimin dhe konstatimin për secilën detyrë përkatëse, ndërsa në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor ka deklaruar dhe sqaruar se : *Pjesë e ekspertizës janë edhe tri shtojcat tabelare, në tabelën 1 të shtojcave janë prezantuar vlerat të TVSH-së, ndëshkimeve, interesit që kanë rezultuar me vlerën totale prej 764,842.41€. Në vazhdim të së njëjtës tabelë është pjesa tabelare pas vendimit të Gjykatës Supreme të datës 10.06.2019, me të cilën gjykata ka kërkuar, ndërsa ATK-DA e ka zbatuar që në vlerë totale është 246,628.56€, përfshirë TVSH-në ndëshkimet dhe interesin. Në vazhdim të së njëjtës tabelë të titulluar “ për polisat e detyrueshëm” në ATK-DA ka mbete pas rivlerësimit se tatimpaguesi është i obliguar për pagesë në vlerë totale prej 518,213.85€, këto dy vlera të polisave vullnetare dhe të detyrueshme janë të paguara në llogarinë e ATK-së (764,842.41€) në këtë vlerë është e përfshirë edhe vlera e TVSH-së në vlerën prej 316,946.11€ vlerë e cila është mbledhë nga tatimpaguesi por nuk është deklaruar në ATK. Rrjedhimisht pasi që kjo vlerë e fundit është në llogari të ATK-së, atëherë sipas vlerësimit të eksperti ndëshkimet dhe interesat të lidhura me këtë vlerë janë vlera që kërkohen për rimbursim nga paditësi.*

Gjykata ka gjetur se pala paditëse shumë e TVSH-së së inkasuar prej 316,946.11 euro për periudhën kontestuese për policat e sigurimit të detyrueshëm, siç është vërtetuar edhe me ekspertizën financiare si më lartë e njëjta nuk e ka kontestuar, pra nuk është objekt kontesti në këtë lëndë, ndërsa si pika kontestuese janë vetëm ndëshkimi prej 164,615.89 euro për mos deklarim të TVSH-së në shumën si më lartë pranë ATK-së, dhe interesi prej 36,651.85 për pagesë të vonuar të TVSH-së në shumën si më lartë, fakte këto të vërtetuara në seancë edhe nga eksperti financiar Mentor Prekazi, e i cili thekson se : *Në vazhdim të së njëjtës tabelë të titulluar “ për polisat e detyrueshëm” në ATK-DA ka mbete pas rivlerësimit se*

*tatimpaguesi është i obliguar për pagesë në vlerë totale prej 518,213.85€, këto dy vlera të polisave vullnetare dhe të detyrueshme janë të paguara në llogarinë e ATK-së (764,842.41€) në këtë vlerë është e përfshirë edhe vlera e TVSH-së në vlerën prej 316,946.11€ vlerë e cila është mbledhë nga tatimpaguesi por nuk është deklaruar në ATK.*

Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe i'a dha besimin e plotë ekspertizës së lartpërmendur dhe sqarimeve të ekspertit në seancë, ngase ekspertiza i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe e arsyetuar mjaftueshëm e të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë konflikt administrativ, si dhe e njëjta është në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Kosovë.

Gjykata i vlerësoj të pa bazuara pretendimet e paditësit në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me të gjeturat e ekspertit financiar si dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

E paditura ATK-ë me vendimin shpjegues publik nr.02/2012 të lëshuar me datë 07.03.2012, ka sqaruar shërbimet e lidhura me sigurimet gjatë periudhës 2010-2012. Gjykata konstaton se ky vendim shpjegues publik që ka të bëjë me trajtimin e transaksioneve të sigurimit dhe ri-sigurimit, neni 4, ka bërë sqarimin e implementimit të dispozitave ligjore të nenit 64 të Ligjit 03/L-146 për TVSH, dhe në këtë drejtim kjo gjykatë sqaron se janë dhënë arsyetime të mjaftueshme se për cilat dispozita ligjore është lëshuar vendimi shpjegues publik nr.02/2012 dt.07.03.2012 nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK.

Me rastin e shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit administrativ kontestues të të paditurës, kjo gjykatë duke u referuar në bazën ligjore që ka aplikuar e paditura ATK-së në arsyetimin e vendimit kontestues, vlerëson se nga interpretimi i dispozitës së nenit 64 të Ligjit nr.03/L-146 për TVSH, del se gjatë periudhës kalimtare prej 01.07.2010 deri 31.12.2012, nuk implementohen dispozitat e nenit 28 të Kreut VIII. Duke marr parasysh se gjatë kësaj

periudhe kalimtare respektivisht për periudhën 01.11.2011 deri 31.12.2011 paditësja nuk ka deklaruar TVSH-në e mbledhur nga policat e sigurimit të detyrueshëm, fakt ky i cili nuk është i kontestuar as nga pala paditëse, andaj Gjykata vlerëson se pretendimet e paditëses nuk gjejnë mbështetje ligjore në asnjë dispozitë që në këtë periudhe kohore të lirohet nga ndëshkimet për mos deklarim të TVSH-së, dhe interesave për pagesa të vonuara të TVSH-së së mbledhur nga policat e sigurimit të detyrueshëm. Me këtë rast gjykata konsideron se nuk mund të zbatohet Ligji 04/L-108 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për TVSH nr.03/L-146, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 03/L-197, pasi që ky ligj nuk ka qenë në fuqi në periudhën 2011 kur paditësja nuk ka deklaruar TVSH-ë në periudhat përkatëse tatimore për policat e sigurimit të detyrueshëm, është fakt i pa kontestueshëm që paditësja e ka mbledhur TVSH-në për periudhën 01.11.2011 deri 31.12.2011 nga këto polica dhe se të njëjtën nuk e ka deklaruar në ATK-ë, përderisa kjo e fundit me kontroll ka inkasuar të njëjtën duke aplikuar kështu me të drejtë ndëshkime dhe interesa. Interesat dhe ndëshkimet gjejnë zbatim sipas neneve 28 dhe 51 të ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Si rezultat, Gjykata konsideron se paditësi në këtë kontest tregtar administrativ ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tija në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para Gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të padisë. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt.

Mbi këtë gjendje të fakteve, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, Gjykata konstaton se vendimi nr.329/2019 i datës 16.09.2019 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.10/2022, datë 29.05.2023

Këshilltare profesionale  
Diana DODAJ SOPJANI

Gj y q t a r i  
Fisnik NULI

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.